



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1146 Prot

Shkodër, më 16.01.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendim “Për miratimin e planit të mbrojtjes sociale 2026–2030, në bashkinë Shkodër”.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR ✓

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin “Për miratimin e planit të mbrojtjes sociale 2026–2030, në bashkinë Shkodër”.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

ALBAN PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 1146 Prot

Shkodër, më 16.01 2026

RELACION “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBROJTJES SOCIALE 2026-2030, NË BASHKINË SHKODËR”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

I. QËLLIMI I VENDIMIT

Ky relacion paraqitet për miratimin nga Këshilli Bashkiak Shkodër të Planit të Mbrojtjes Sociale 2026–2030, si dokument strategjik dhe operacional që udhëzon politikat vendore në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimeve të kujdesit shoqëror, rinisë dhe strehimit social, me synim rritjen e mirëqenies, përfshirjes sociale dhe kohezionit komunitar në territorin e Bashkisë Shkodër.

II. BAZA LIGJORE

Plani i Mbrojtjes Sociale 2026–2030 është hartuar dhe propozohet për miratim në mbështetje të kuadrit ligjor kombëtar në fuqi, konkretisht:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, 23, 24 dhe 25, që përcakton përgjegjësitë e bashkisë në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore, strehimit social, arsimit, kulturës dhe rinisë;
- Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, veçanërisht neni 36, për planifikimin social vendor;
- Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 46;
- Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, i ndryshuar, neni 7;
- Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, neni 73;
- Ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, neni 22;

- Strategjive dhe planeve kombëtare sektoriale për mbrojtjen sociale, rininë, strehimin, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.

Ky plan është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër dhe strategjitë kombëtare përkatëse.

III. DIAGNOZA SOCIALE

Diagnoza sociale e përfshirë në Plan bazohet në analiza statistikore, konsultime me aktorë institucionalë dhe komunitarë, si dhe në gjetjet e planeve sektoriale ekzistuese.

Analiza evidencon:

- Plakje të popullsisë dhe emigracion të vazhdueshëm, veçanërisht në zonat rurale dhe malore;
- Pabarazi të theksuara urbane–rurale në aksesin ndaj shërbimeve shoqërore;
- Prani të varfërisë së qëndrueshme dhe varësi nga ndihma ekonomike në familjet vulnerabël;
- Akses të kufizuar të personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve në nevojë dhe të moshuarve në shërbime të strukturuar;
- Papunësi dhe mungesë orientimi profesional te të rinjtë, pavarësisht potencialit të lartë rinor;
- Probleme të vazhdueshme në strehimin social, sidomos për familjet me të ardhura të ulëta dhe komunitetet rome dhe egjiptiane.

Këto sfida tregojnë nevojën për një qasje të integruar, të koordinuar dhe afatgjatë në mbrojtjen sociale.

IV. SHTYLLAT STRATEGJIKE TË PLANIT

Plani i Mbrojtjes Sociale 2026–2030 strukturohet rreth tre shtyllave strategjike kryesore:

SHTYLLA I

OFRIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE TË KUJDESIT SHOQËROR

Kjo shtyllë strategjike synon ndërtimin dhe konsolidimin e një sistemi të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe me cilësi të lartë të shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e

Bashkisë Shkodër, të orientuar drejt nevojave reale të individëve, familjeve dhe komuniteteve vulnerabël.

Objektivat kryesore të kësaj shtylle përfshijnë:

- Zgjerimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare, me fokus të veçantë në zonat rurale, periferike dhe të thella;
- Përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve për fëmijët në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe individët në rrezik përjashtimi social;
- Forcimin e mekanizmave të menaxhimit të rasteve dhe koordinimit ndërsektorial ndërmjet shërbimeve sociale, shëndetësore, arsimore dhe të rendit publik;
- Rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të shërbimeve sociale përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe standardizimit të praktikave të punës;
- Mbështetjen e shërbimeve parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese, me qëllim reduktimin e varfërisë, dhunës dhe varësisë nga ndihma ekonomike.

Nëpërmjet kësaj shtylle synohet kalimi nga një qasje reaguese në një qasje parandaluese dhe zhvillimore në mbrojtjen sociale.

SHTYLLA II

PJESËMARRJA AKTIVE E TË RINJVE NË SHOQËRI

Shtylla e dytë strategjike synon fuqizimin e të rinjve si aktorë kyç të zhvillimit lokal dhe ndërtimin e politikave rinore gjithëpërfshirëse, të bazuara në nevojat, potencialet dhe aspiratat e tyre.

Kjo shtyllë parashikon:

- Zhvillimin dhe funksionalizimin e infrastrukturës rinore (qendra rinore, hapësira komunitare, platforma digjitale);
- Promovimin e arsimit joformal, formimit profesional, sipërmarrjes rinore dhe inovacionit social;
- Nxitjen e punësimit dhe vetëpunësimit të të rinjve, përmes bashkëpunimit me sektorin privat, institucionet e arsimit dhe strukturat e formimit profesional;
- Rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje, jetën publike dhe proceset konsultative në nivel vendor;
- Mbështetjen e të rinjve në rrezik social, përfshirë të rinjtë NEET, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata nga familje në vështirësi ekonomike.

Nëpërmjet kësaj shtylle synohet krijimi i një mjedisi mbështetës për zhvillimin personal, profesional dhe qytetar të të rinjve, si dhe parandalimi i migracionit dhe përjashtimit social.

SHTYLLA III

STREHIMI SOCIAL

Shtylla e tretë strategjike ka në fokus garantimin e së drejtës për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet dhe individët në nevojë, si një element thelbësor i mbrojtjes sociale dhe kohezionit shoqëror.

Kjo shtyllë synon:

- Zgjerimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit të banesave sociale në pronësi të Bashkisë Shkodër;
- Zbatimin e instrumenteve financiare të strehimit social, përfshirë subvencionimin e qirasë, grantet për rikonstrukcion dhe format e tjera mbështetëse;
- Prioritizimin e familjeve me të ardhura të ulëta, familjeve njëprindërore, viktimave të dhunës, personave me aftësi të kufizuara dhe komuniteteve në nevojë;
- Integrimin e politikave të strehimit me shërbimet sociale, punësimin dhe arsimin, për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë;
- Rritjen e transparencës dhe drejtësisë në përzgjedhjen e përfituesve dhe menaxhimin e programeve të strehimit.

Nëpërmjet kësaj shtylle synohet reduktimi i pasigurisë së banimit dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për kategoritë më vulnerabël të popullsisë.

V. STRATEGJIA E MONITORIMIT DHE KOMUNIKIMIT

Plani parashikon një mekanizëm të strukturuar monitorimi dhe raportimi, i cili përfshin:

- Përcaktimin e indikatorëve të qartë të performancës për çdo shtyllë dhe prioritet;
- Raportim periodik mbi ecurinë e zbatimit të planit;
- Përdorimin e sistemeve digjitale dhe regjistrave kombëtarë për menaxhimin e rasteve;
- Përfshirjen e strukturave bashkiake, institucioneve partnere dhe shoqërisë civile në procesin e monitorimit.

Strategjia e komunikimit synon transparencë, informim të rregullt të publikut dhe konsultim të vazhdueshëm me komunitetin dhe aktorët socialë, me fokus të veçantë te grupet vulnerabël.

VI. PËRFUNDIM

Miratimi i Planit të Mbrojtjes Sociale 2026–2030 nga Këshilli Bashkiak Shkodër përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të qeverisjes sociale vendore, përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve dhe ndërtimit të një komuniteti më gjithëpërfshirës dhe solidar.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i Planit të Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Shkodër për periudhën 2026–2030.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

K R Y E T A R

Benet Beci

**ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
ALBAN PREKA**

Drejtoria e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë

Edlita Shashi Shashi

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik

Arbina Kruja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 1146/1 Prot

Shkodër, më 16.01.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBROJTJES SOCIALE 2026–2030, NË BASHKINË SHKODËR”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar të nenit 24, nenit 54 shkronja “k”; Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, dhe sipas relacionit të përgatitur,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Planin e mbrojtjes sociale 2026–2030, në bashkinë Shkodër” sipas materialit bashkëngjitur pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
ALBAN PREKA**



Zv/Kryetar

Benet Beci

Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë

Edlita Shashi

Drejtorja Juridike

B. Ljepus

Drejtorja e Shërbimeve Sociale

Orlinda Kruja

PLANI I MBROJTJES SOCIALE – BASHKIA E SHKODRËS

2026-2030

Përmbajtja

PJESA I: KORNIZA E PËRGJITHSHME DHE METODOLOGJIA	5
Konteksti dhe qasja	5
Baza ligjore.....	6
Korniza strategjike kombëtare dhe lokale	6
Metodologjia e punës dhe burimet e përdorura.....	7
Partnerët sociale të Bashkisë Shkoder.....	8
 PJESA II : DIAGNOZA.....	8
 PJESA III: SHTYLLAT STRATEGJIKE	13
SHTYLLA I – Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror	15
Prioriteti 1: Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror ekzistuese...	16
Prioriteti 2: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për grupet në nevojë.....	17
Prioriteti 3: Forcimi i mekanizmave lokalë për një mbrojtje sociale efektive dhe të integruar.....	19
 SHTYLLA II – Pjesëmarrja aktive e të rinjve në shoqëri	21
Prioriteti 4: Infrastrukturë cilësore për të rinjtë, brenda dhe jashtë shkollës.....	22
Prioriteti 5: Të rinj inovativë, krijues dhe të shëndetshëm	23
Prioriteti 6 Të rinj të angazhuar dhe pjesëmarrës aktivë në komunitet	25
 SHTYLLA III – Strehimi Social.....	27
Prioriteti 7: Garantimi i mundësisë për strehim social për personat në nevojë.....	28
Prioriteti 8: Zgjerimi i mundësive të strehimit social në gjithë territorin e bashkisë.....	29
 PJESA IV: STRATEGJIA E MONITORIMIT DHE KOMUNIKIMIT	31
 SHTOJCAT	32

Parathënie

Si Kryetar i Bashkisë së Shkodrës, jam krenar të prezantoj Planin e Mbrojtjes Sociale të Bashkisë së Shkodrës për periudhën 2026 – 2030, një dokument strategjik që pasqyron vizionin tonë përbashkët për një komunitet më gjithëpërfshirës, më të kujdesshëm dhe më të qëndrueshëm.

Bashkia e Shkodrës është një ndër më të rëndësishmet në Shqipëri, jo vetëm për madhësinë e territorit të saj, por edhe për pasurinë e historisë, kulturës dhe njerëzve të saj. Në zemër të saj ndodhet qyteti ynë, Shkodra, një vend që për shekuj me radhë ka pasqyruar kreativitetin, qëndrueshmërinë dhe solidaritetin. Është një qytet që lidh traditën me modernitetin dhe një komunitet që vazhdon të frymëzojë krenari përtej kufijve të tij.

Bashkia jonë shtrihet në një terren me peizazhe të larmishme, nga malet dhe fshatrat që ruajnë traditat tona, deri te qendra dinamike urbane që nxit inovacionin dhe rritjen. Megjithatë, ky diversitet na kujton edhe sfidat me të cilat përballemi: zonat rurale ku qasja në shërbime mbetet e kufizuar, komunitetet e prekura nga migrimi dhe një popullsi në plakje që kërkon më shumë kujdes dhe përfshirje. Këto realitete nuk na dobësojnë; ato forcojnë vendosmërinë tonë për të ndërtuar një Shkodër që nuk lë askënd pas.

Ekonomia jonë ndërtohet mbi sektorë kyç si bujqësia, blegtoria, peshkimi, shërbimet dhe turizmi, të cilët përbëjnë bazën e zhvillimit ekonomik të bashkisë. Bukuria e vijës sonë bregdetare, pasuria e trashëgimisë sonë natyrore dhe kreativiteti i popullit tonë na japin potencial të madh për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Megjithatë ne duhet të adresojmë sfidat e vazhdueshme të: nevojën për infrastrukturë më të mirë, rritjen e mundësive për të rinjtë dhe një ekuilibër më të drejtë të zhvillimit në të gjithë territorin tonë.

Shkodra ka qenë gjithmonë një simbol i qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes. Me vizionin e duhur dhe përpjekjen e përbashkët, ajo do të vazhdojë të jetë një vend ku trashëgimia takon progresin dhe ku çdo qytetar ndihet pjesë e një të ardhmeje të përbashkët.

Ky plan është konceptuar duke u bazuar në këtë frymë. Ky plan përmbledh katër nga strategjitë tona kryesore sektoriale - të përqendruara në zhvillimin e shërbimeve e kujdesit shoqëror, strehimin social, barazinë gjinore dhe të rinjtë - në një kornizë të vetme udhëzuese dhe koherente. Duke unifikuar këto dokumente, ne synojmë të forcojmë koordinimin midis institucioneve, të shmangim fragmentimin dhe të ofrojmë politika sociale më efektive për qytetarët tanë.

Plani është strategjik dhe operacional. Ai përcakton masa konkrete afatshkurtra dhe afatgjata për të përmirësuar mirëqenien sociale për të gjithë anëtarët e komunitetit, dhe në veçanti për fëmijët në rrezik, të rinjtë e papunë, komunitetet rome dhe egjiptiane, personat e moshuar në rrezik izolimi, personat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës në familje. Mbi të gjitha, ai përfaqëson përgjegjësinë tonë të përbashkët për të mbrojtur dhe fuqizuar çdo anëtar të komunitetit tonë.

Ky dokument është rezultat i konsultimeve dhe bashkëpunimit të gjerë, me qytetarët, institucionet lokale dhe rajonale, agjencitë qeveritare qendrore, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Kontributet e tyre kanë siguruar që plani të pasqyrojë nevojat dhe prioritetet reale të komunitetit.

Plani është i strukturuar rreth tre shtyllave strategjike:

1. Zhvillimi dhe forcimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për grupet më vulnerabël.
2. Fuqizimi dhe përfshirja aktive e të rinjve përmes arsimit, punësimit dhe angazhimit qytetar.
3. Sigurimi i aksesit të barabartë në strehim përmes mbështetjes institucionale dhe programeve sociale.

Vizioni ynë është për një Shkodër që rritet duke u kujdesur, ku çdo banor, pavarësisht moshës, prejardhjes apo rrethanave, mund të jetojë me dinjitet, siguri dhe mundësi.

I ftoj të gjitha institucionet, organizatat dhe qytetarët të bashkohen me ne për ta kthyer këtë vizion në realitet.

[nënshkrimi]

Benet Beci,

Kryetar i Bashkisë së Shkodrës

PJESA I: KORNIZA E PËRGJITHSHME DHE METODOLOGJIA

Konteksti dhe qasja

Konteksti social në Bashkinë Shkodër karakterizohet nga një ndërthurje sfidash demografike, sociale dhe ekonomike. Plakja e popullsisë, emigracioni dhe papunësia kanë rritur cenueshmërinë e shumë individëve dhe familjeve, duke sjellë rritje të kërkesës për shërbime shoqërore. Grupe të caktuara, përfshirë të rinjtë, familjet në vështirësi ekonomike dhe komunitetet e marginalizuara, vijnë të përballen me barriera të shumta për përfshirjen sociale dhe aksesin në shërbime thelbësore.

Në përgjigje të kësaj situate, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi gjithëpërfshirës dhe të koordinuar të mbrojtjes sociale, i cili garanton mbështetje për të gjithë banorët, veçanërisht për ata që janë në rrezik përjashtimi. Ky angazhim pasqyron një vullnet të fortë vendor për drejtësi sociale, barazi dhe solidaritet.

Në vijim të kësaj qasjeje të koordinuar ndaj mbrojtjes sociale, Bashkia ka vlerësuar rëndësinë e hartimit të një plani të integruar, të bazuar në parimet e kohezionit social, barazisë, përfshirjes dhe një qasjeje të mbështetur në të drejtat e njeriut, i cili bashkon sektorë dhe aktorë të ndryshëm nën një vizion të përbashkët dhe një kuadër të koordinuar veprimi.

Në tërësi, Bashkia Shkodër synon që:

- Të harmonizojë ndërhyrjet në fushat e mbrojtjes sociale, strehimit dhe rinisë;
- Të parandalojë fragmentarizimin e shërbimeve dhe mbivendosjen e përpjekjeve;
- Të integrojë në mënyrë të qëndrueshme vizionin për barazinë gjinore në të gjitha veprimet e saj në territor;
- Të sigurojë një përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe financiare;
- Të forcojë ndikimin e përgjithshëm social përmes koordinimit efektiv ndërinstitutional.

Në vend që të zëvendësojë planet ekzistuese sektoriale, kjo qasje e integruar mbështetet mbi strukturat dhe objektivat e tyre tashmë të konsoliduara, duke krijuar një kuadër të unifikuar që rrit koherencën dhe sinergjinë ndërmjet tyre. Në këtë kuptim, plani shërben si mjeti i vetëm strategjik dhe operacional, një platformë e përbashkët që harmonizon veprimet lokale me prioritetet e përbashkëta për mirëqenie sociale dhe përfshirje.

Baza ligjore

Plani është hartuar dhe mandatuar nga bashkia, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në aktet ligjore të mëposhtme të qeverisë qendrore, si dhe në aktet nënligjore përkatëse që burojnë prej tyre:

- **Neni 9 i Ligjit nr. 39/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**, i cili thekson të drejtën dhe aftësinë e bashkisë për të përcaktuar dhe zbatuar strategji vendore;
- **Neni 23 i Ligjit nr. 39/2015**, i cili përcakton përgjegjësinë e bashkisë për ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e godinave të shkollave 9-vjeçare dhe të arsimit të mesëm të përgjithshëm;
- **Neni 24 i Ligjit nr. 39/2015**, i cili përcakton rolin dhe përgjegjësinë e bashkisë në krijimin dhe administrimin e shërbimeve shoqërore, si dhe në ndërtimin dhe administrimin e strehimit social;
- **Neni 25 i Ligjit nr. 39/2015**, i cili përcakton përgjegjësinë e bashkisë në promovimin e kulturës, sportit dhe veprimtarive rekreative për qytetarët e saj;
- **Neni 36 i Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”**, i cili ngarkon bashkinë me detyrimin për të zbatuar planifikimin social në nivel vendor, veçanërisht në lidhje me administrimin e shërbimeve shoqërore dhe standardet e funksionimit të tyre;
- **Neni 46 i Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**, i cili nënvizon rolin dhe përgjegjësinë e bashkisë në pasqyrimin e të drejtave të fëmijëve në planet vendore të zhvillimit;
- **Neni 7 i Ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”**, i ndryshuar në vitin 2025, i cili thekson rolin e bashkisë në hartimin e politikave vendore për rininë, si dhe në krijimin dhe mirëmbajtjen e qendrave rinore në territorin e bashkisë;
- **Neni 73 i Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”**, i ndryshuar, i cili thekson rolin e bashkisë në përcaktimin e politikave vendore për strehimin social;
- **Neni 22 i Ligjit nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”**, i cili përcakton rolin dhe përgjegjësitë e bashkisë në zbatimin e politikave dhe masave për promovimin e barazisë gjinore në nivel vendor.

Lista e plotë e kuadrit ligjor gjendet e bashkëlidhur si aneks i planit.

Korniza strategjike kombëtare dhe lokale

Plani është hartuar duke iu referuar një sërë strategjish kombëtare të miratuara, si më poshtë:

- Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030;
- Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029;
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare për Strehimin Social 2016–2025;
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026;


- Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025;
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026;
- Plani Kombëtar për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025;
- Plani Kombëtar i Veprimit për të Moshuarit 2025–2030.

Në nivel vendor, Bashkia Shkodër ka hartuar **Planin e Përgjithshëm Vendor 2015–2030**, i cili përcakton vizionin e përgjithshëm të zhvillimit të bashkisë. Një element i rëndësishëm i këtij plani, me relevancë të drejtpërdrejtë për planin e mbrojtjes sociale, lidhet me zhvillimin dhe zgjerimin e qendrave komunitare, duke reflektuar angazhimin e bashkisë për të siguruar që mbështetja dhe shërbimet të ofrohen përmes strukturave komunitare.

Më herët, bashkia ka hartuar një sërë planesh sektoriale, si Plani Vendor Social, Plani Vendor për Rininë, Plani Vendor për Barazinë Gjinore, Plani Vendor i Strehimit dhe Plani Vendor i Veprimit për Komunitetet Rome dhe Egjiptiane, të cilat kanë shërbyer si bazë dhe referencë për procesin e hartimit të këtij plani.

Metodologjia e punës dhe burimet e përdorura

Plani shërben si një kuadër strategjik gjithëpërfshirës, i cili konsolidon dhe integron drejtimit e politikave sociale të bashkisë në një dokument të vetëm dhe të unifikuar. Ai bashkon prioritetet, objektivat dhe masat kryesore që udhëheqin angazhimin e Bashkisë Shkodër për ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës, të drejtë dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale, kujdesit shoqëror, strehimit, shërbimeve për rininë dhe barazinë gjinore. Plani përcakton një vizion koherent për forcimin e kapaciteteve vendore, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe garantimin që të gjithë qytetarët, veçanërisht ata në situata vulnerabël, të kenë akses në mbështetje cilësore në të gjithë territorin e bashkisë.



Hartimi i këtij plani është mbështetur në një qasje metodologjike të harmonizuar, të bazuar në evidenca dhe pjesëmarrje, si dhe në përputhje me politikat kombëtare.

Procesi ka përfshirë konsultime me një gamë të gjerë aktorësh të interesuar, përfshirë të rinj, familje në nevojë, persona me aftësi të kufizuara, përfaqësues të komuniteteve rome dhe egjiptiane, aktorë publikë dhe jopublikë; si edhe diskutime të fokusuar me punonjës socialë, specialistë të strehimit dhe profesionistë të shëndetit publik. Janë përdorur të dhëna statistikore të përditësuara nga Drejtoria e Gjendjes Civile, institucionet arsimore, njësitë administrative dhe INSTAT, për të garantuar saktësinë dhe vlefshmërinë e analizës. Plani pasqyron gjithashtu gjetjet nga analizat SWOT dhe PESTLE të realizuara gjatë fazave përgatitore të planifikimit sektorial. Për informacion të mëtejshëm,

dokumentet origjinale të draftit që përshkruajnë proceset individuale të hartimit janë bashkëlidhur si anekse të planit.

Përmes krahasimit, integritit dhe përmirësimit të objektivave strategjikë të dokumenteve sektoriale tashmë të hartuara¹, ky plan i unifikuar krijon një strukturë të përmbledhur dhe funksionale, e cila shmang mbivendosjet dhe forcon koherencën ndërmjet fushave të politikave.

Aktorët sociale të Bashkisë Shkodër

Bashkia Shkodër ka ndërtuar një model të konsoliduar të bashkëpunimit ndërsektorial me aktorët socialë, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj mbrojtjes sociale. Në nivel institucional, bashkia bashkëpunon ngushtësisht me institucionet qendrore që veprojnë në territor, përfshirë Zyrën Vendore të Arsimit, Zyrën Vendore të Punësimit dhe shërbimet publike shëndetësore, me qëllim nxitjen e planifikimit të integruar dhe ofrimit të harmonizuar të shërbimeve ndërsektoriale. Ky bashkëpunim mundëson koordinimin efektiv të ndërhyrjeve në fushat e arsimit, punësimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, duke garantuar që përgjigjet ndaj nevojave sociale të jenë gjithëpërfshirëse dhe të mirëpërafruara.

Krahas aktorëve institucionalë, bashkia bashkëpunon në mënyrë aktive me një rrjet të gjerë aktorësh jofitimprurës dhe privatë. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol kyç në ndërhyrjet në terren, mobilizimin komunitar dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara për grupet vulnerabël, ndërsa partnerët e sektorit privat kontribuojnë në ruajtjen e dimensionit social të zhvillimit vendor përmes krijimit të mundësive të punësimit, nismave të përgjegjësive sociale dhe mobilizimit të burimeve vendore. Së bashku, këto aktorë forcojnë një model të ofrimit të shërbimeve të bazuar në komunitet, i cili rrit kapacitetet vendore, nxit përfshirjen dhe mbështet kohezionin social në të gjithë territorin.

Bashkia ka siguruar gjithashtu që të gjithë aktorët socialë të jenë konsultuar në mënyrë gjithëpërfshirëse gjatë hartimit të këtij Plani dhe do të vijojnë të jenë të përfshirë aktivisht në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij. Pjesëmarrja e tyre është thelbësore për ruajtjen e relevancës, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve sociale në nivel vendor. Një listë e detajuar e institucioneve dhe organizatave të konsultuara gjendet e bashkëlidhur si aneks i këtij Plani.

PJESA II: DIAGNOZA

¹ Dokumentet përkatëse sektoriale u përgatitën në bashkëpunim midis bashkisë dhe partnerëve të ndryshëm teknikë. Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Rinjtë u hartuan me mbështetjen e Woman to Woman dhe Europe Goes Local; Plani i Strehimit Social u hartua me mbështetjen e UNDP-së në kuadër të programit Leave No One Behind; Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore u hartua me mbështetjen e XX ; dhe Plani Social Lokal u zhvillua me mbështetjen e BE-së për Përfshirjen Sociale në Shqipëri, i zbatuar nga GOPA Worldwide Consultants.

Diagnoza e mëposhtme përfaqëson një përmbledhje të informacionit të analizuar gjatë hartimit të katër planeve sektoriale

Konteksti demografik

Bashkia Shkodër përbën njësinë më të madhe territoriale dhe demografike në Qarkun Shkodër, duke u shtrirë në një sipërfaqe prej 872.71 km² dhe duke përfshirë një qendër urbane dhe nëntëdhjetë e dy fshatra. Administrativisht, ajo përbëhet nga njëmbëdhjetë njësi: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Me 212,467 banorë të regjistruar zyrtarisht, bashkia përfaqëson rreth 62% të popullsisë së qarkut. Struktura demografike karakterizohet nga një përqendrim i lartë në qytetin e Shkodrës, ku jeton rreth 55% e popullsisë totale (116,285 banorë), ndërsa njësia administrative rurale me popullsinë më të madhe, Rrethinat, numëron 28,894 banorë.

Profili demografik i Bashkisë Shkodër evidenton pabarazi të vazhdueshme urbane-rurale, plakje të popullsisë dhe flukse të theksuara migrimi të brendshëm dhe të jashtëm. Këta faktorë kontribuojnë në shpopullimin gradual të zonave periferike dhe malore, si Pulti, Shala dhe Shoshi, ku aksesit i kufizuar në infrastrukturën sociale dhe ekonomike ul qëndrueshmërinë e komuniteteve dhe rrit cenueshmërinë e tyre. Reduktimi i vazhdueshëm i popullsisë në moshë pune ka filluar të ushtrojë presion strukturor mbi tregun lokal të punës dhe mbi ofrimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë, ndërkohë që rritet pesha relative e popullsisë së moshuar.

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në vitin 2022 në bashki janë regjistruar 44,889 të rinj të grupmoshës 15–29 vjeç. Brenda këtij grupi, grupmosha 19–24 vjeç përbën numrin më të madh (17,614 individë), e ndjekur nga grupmosha 25–29 vjeç me 17,085 individë dhe ajo 15–18 vjeç me 10,190 individë. Raporti gjinor mbetet i balancuar, me 21,530 vajza dhe gra të reja dhe 23,359 djem dhe burra të rinj. Ky segment demografik përfaqëson një potencial të rëndësishëm për zhvillimin vendor, me kusht që përfshirja sociale, arsimit dhe perspektivat e punësimit të të rinjve të mbështeten në mënyrë të qëndrueshme dhe të synuar.

Kushtet sociale brenda territorit

Bashkia vijon të përballet me sfida sociale të shumëfishta, të cilat ndërthuren ndërmjet varfërisë, punësimit, arsimit dhe aksesit në kujdesin shoqëror. Në vitin 2023, 1,616 familje ishin të regjistruara si përfituese të ndihmës ekonomike, çka dëshmon praninë e vatrave të qëndrueshme të varfërisë, veçanërisht në zonat rurale dhe periurbane. Shpërndarja territoriale e varfërisë lidhet ngushtësisht me aksesin e kufizuar në shërbime bazë dhe mundësi punësimi, duke riprodhuar cikle të varësisë dhe përjashtimit social.

Në grupin e personave me aftësi të kufizuara (PAK), 2,763 individë përfitojnë pagesa për aftësinë e kufizuar, por vetëm 254 prej tyre (rreth 9.2%) përfitojnë nga shërbime shoqërore të strukturuar. Kjo tregon një hendek të theksuar në ofrimin e shërbimeve dhe nxjerr në pah mbizotërimin e mbështetjes financiare nëpërmjet transfertave monetare, në

krahasim me ndërhyrjet në komunitet. Situata është veçanërisht kritike për të rriturit me aftësi të kufizuara, të cilët mbeten kryesisht jashtë programeve të punësimit apo trajnimit, si dhe për ata që jetojnë në zonat rurale, ku mbulimi me shërbime shoqërore është pothuajse inekzistent. Ky çekuilibër ndërmjet ndihmës financiare dhe ofrimit të shërbimeve nënvizon nevojën për një model më gjithëpërfshirës, që lidh mbrojtjen sociale me përfshirjen, rehabilitimin dhe fuqizimin.

Fëmijët në nevojë përbëjnë një tjetër grup prioritar. Në vitin 2023 u identifikuan 3,291 fëmijë në nevojë për mbështetje shoqërore, por shërbimet e dedikuara për këtë grup mbeten të kufizuara në shtrirje dhe cilësi. Shërbimet ditore dhe ato me bazë komunitare janë të përqendruara kryesisht në zonën urbane, duke lënë shumë fëmijë në zonat rurale pa akses në edukimin e hershëm apo mbështetje psikosociale. Fëmijët e komuniteteve rome dhe egjiptiane preken në mënyrë të pabarabartë nga barrierat në arsim, veçanërisht në regjistrimin dhe ndjekjen e kopshteve dhe parashkollloreve. Mungesa e një databaze të integruar ndërmjet bashkisë dhe organizatave të shoqërisë civile kufizon më tej monitorimin efektiv dhe referimin e rasteve vulnerabël.

Popullsia e të moshuarve, e cila po rritet si në numër absolut ashtu edhe në peshë relative, përballet me izolim social, të ardhura të kufizuara dhe alternativa të pamjaftueshme kujdesi. Shumica e të moshuarve mbështeten te familja ose te marrëveshje informale, ndërkohë që shërbimet shoqërore të bashkisë ofrojnë vetëm ndërhyrje minimale në terren. Kujdesi institucional mbetet i kufizuar, ndërsa asistenca në banesë, thelbësore për ruajtjen e pavarësisë dhe dinjitetit në moshën e tretë, ofrohet vetëm në shkallë pilot. Zhvendosja demografike drejt plakjes kërkon zgjerim urgjent të shërbimeve të kujdesit afatgjatë dhe atyre komunitare, si dhe një rikonceptim të mbrojtjes sociale që parashikon kërkesat e ardhshme, në vend që të reagojë vetëm ndaj situatave të krizës.

Rastet e dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore, ndonëse kanë shënuar një rënie të kohëve të fundit në numrin e rasteve të raportuara, vijojnë të përfaqësojnë rreziqe të thella dhe të rrënjosura, veçanërisht për gratë, fëmijët dhe grupet ekonomikisht të varura. Forcimi i rolit mbrojtës të bashkisë, përmes mekanizmave të integruar të referimit dhe rritjes së kapaciteteve të punës sociale, mbetet një kusht thelbësor për parandalimin dhe rehabilitimin.

Shërbimet e kujdesit shoqëror dhe kapacitetet institucionale

Sistemi vendor i mbrojtjes sociale ndodhet në një fazë konsolidimi gradual. Shërbimet janë kryesisht të përqendruara në zonat urbane, me një shtrirje territoriale të pabarabartë që lë të pamjaftueshëm shërbimin e njëjësive administrative malore dhe të largëta. Shërbimet ekzistuese përfshijnë qendra ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, qendra komunitare për grupet vulnerabël, si dhe partneritete me organizata joqeveritare që ofrojnë mbështetje psikosociale ose arsimore. Megjithatë, mbulimi, sigurimi i cilësisë dhe qëndrueshmëria e shërbimeve shoqërore mbeten sfida kyçe.

Kuadri institucional i bashkisë mbështetet ligjërisht në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili u ngarkon njëjësive të vetëqeverisjes vendore përgjegjësi të

qarta në fushat e shërbimeve sociale, kulturës, arsimit, sportit, rinisë dhe strehimit social. Megjithatë, përmbushja efektive e këtyre përgjegjësisve kufizohet nga burime financiare dhe njerëzore të pamjaftueshme, sisteme të pamjaftueshme të të dhënave dhe një koordinim i fragmentuar ndërmjet drejtorive vendore, institucioneve rajonale dhe agjencive qendrore. Kalimi drejt një modeli të decentralizuar të kujdesit social ka zgjeruar kompetencat vendore më shpejt sesa kapacitetet reale për zbatimin e tyre.

Ngritja e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të informacionit për shërbimet sociale, të ndërlidhur me databazat kombëtare, do të përmirësonte identifikimin e përfituesve, monitorimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve. Po ashtu, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet bashkisë, zyrave të punësimit, shkollave, shërbimeve shëndetësore dhe shoqërisë civile do të mbështeste hartimin e ndërhyrjeve të integruara, që i përgjigjen realiteteve komplekse të familjeve në nevojë.

Arsimi, aftësitë dhe të rinjtë

Arsimi mbetet një shtyllë themelore e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik në Shkodër, duke ofruar rrugën kryesore për të rinjtë për të fituar aftësi, vetëbesim dhe pavarësi. Gjatë vitit shkollor 2022–2023, 12,230 fëmijë ndoqën 86 shkolla publike në qytet dhe në njësitë administrative. Prej tyre, 26 shkolla funksionojnë si qendra komunitare, duke zgjeruar përdorimin e hapësirave të tyre për aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative. Në Bashki funksionojnë tetë shkolla të mesme të përgjithshme, pesë të vendosura në qytet dhe tre në njësitë administrative, me 2,246 nxënës, ndërsa tre shkolla janë profesionale me 1,264 nxënës (700 në “Hamdi Bushati”, 100 në “Kolë Margjini” dhe 464 në “Arben Broci”).

Pavarësisht kësaj infrastrukture arsimore, papunësia e të rinjve mbetet një shqetësim madhor. Shumë të rinj vuajnë nga mungesa e orientimit në karrierë, këshillim profesional dhe rrugë të strukturuar nga arsimi drejt punësimit. Mungesa e planeve individuale të karrierës ose e shërbimeve këshilluese të personalizuar pengon kalimin e tyre në tregun e punës. Institucionet e arsimit dhe formimit profesional ofrojnë programe të vlefshme në fushat e hotelërisë, turizmit, teknologjisë, arteve dhe kulturës, por lidhja ndërmjet këtyre programeve dhe nevojave reale të tregut të punës mbetet ende e dobët.

Duke njohur këto sfida, Bashkia Shkodër ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt fuqizimit të të rinjve. Një nismë kulmore ishte ngritja e qendrës së parë publike rinore, Atelie, e konceptuar si një hapësirë dinamike për mësim, pjesëmarrje dhe inovacion. Qendra funksionon si një nyje për programe qytetare, arsimore, punësimi dhe sipërmarrjeje, si edhe për iniciativa artistike, kulturore, sociale dhe shëndetësore. Ajo promovon pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike dhe në vendimmarrje, duke nxitur si angazhimin qytetar ashtu edhe shprehjen krijuese. Atelie dallohet si një model i shkëlqyer i përfshirjes dhe pjesëmarrjes; megjithatë, qëndrueshmëria dhe ndikimi i saj mund të forcohen më tej përmes zgjerimit të këtij modeli në një rrjet hapësirash rinore lokale, veçanërisht në njësitë administrative rurale ku mundësitë mbeten të kufizuara. Kjo shënon një angazhim të rëndësishëm institucional ndaj parimeve të përfshirjes, barazisë së mundësive dhe qytetarisë aktive, ashtu siç pasqyrohet në politikat kombëtare për rininë.

Potenciali rinor në Shkodër është i konsiderueshëm. Shfrytëzimi i tij kërkon një mjedis mbështetës që ndërthur arsimin, formimin, punësimin dhe pjesëmarrjen sociale. Krijimi i hapësirave komunitare interaktive, zgjerimi i arsimit informal dhe joformal, si dhe garantimi i aksesit në aktivitete kulturore dhe sportive mund të forcojnë integrimin e të rinjve dhe të kundërshtojnë emigrimin. Për më tepër, bashkia mund të luajë një rol katalizator duke lehtësuar bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet institucioneve arsimore, shoqërisë civile dhe aktorëve privatë për të nxitur iniciativa të udhëhequra nga të rinjtë.

Strehim Social

Aksesi në strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm mbetet një komponent qendror i përfshirjes sociale në Bashkinë Shkodër. Pavarësisht përmirësimeve graduale në infrastrukturën urbane dhe kuadrin rregullator, pasiguria në strehim vazhdon të prekë familjet me të ardhura të ulëta, komunitetet rome dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me një prind. Fondi i banesave bashkiake mbetet i kufizuar si në sasi ashtu edhe në cilësi, ndërkohë që kërkesa ka vijuar të rritet për shkak të lëvizjeve të popullsisë, rritjes së çmimeve të qirave në tregun privat dhe ndryshimeve demografike.

Në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, Bashkia ka zbatuar disa instrumente strehimi, përfshirë subvencionin e interesit të kredisë hipotekore për strehim, subvencionet e qirasë, grantet e menjëhershme dhe strehimin social me qira, ndërsa kërkesa për këto skema mbetet e lartë. Në vitin 2021, u regjistruan gjithsej 318 aplikime në të gjitha programet (208 për subvencione kredie, 108 për subvencione qiraje dhe 2 për përmirësim banese). Nga të gjitha aplikimet, 65% lidhej me pagesat e interesit të kredive hipotekore të subvencionuara, ku 37.5% ishin paraqitur nga çiftet e reja. Një numër më i vogël aplikimesh u paraqit nga persona të përndjekur politikë, viktimë të dhunës në familje, jetimë dhe zjarrfikës. Subvencionet e qirasë përbënin 34% të të gjitha aplikimeve, ku familjet me një prind përfaqësonin 26% të përfituesve. Vetëm një aplikim lidhej me pastrehësinë e shkaktuar nga fatkeqësi natyrore. Dy familje përfituan nga granti i menjëhershëm, ekuivalent me 10% të vlerës së një banese me kosto të ulët, pas miratimit sipas Vendimit nr. 555, datë 15.07.2020.

Gjatë periudhës 2018–2022, numri i familjeve të mbështetura përmes programeve të strehimit social u rrit ndjeshëm (nga 50 përfitues në vitin 2018 në 139 në vitin 2022) duke prezantuar përmirësim të aksesit në informacion dhe zbatim të qëndrueshëm të politikave. Në të njëjtën periudhë, numri i njësive të strehimit social në pronësi ose administrim të Bashkisë u rrit nga 24 në 79. Në vitin 2022, 20 familje u akomoduan drejtpërdrejt në strehim social me qira. Numri i përfituesve të subvencionit të qirasë arriti kulmin në 163 në vitin 2020, përpara se të binte në 36 në vitin 2022, duke reflektuar si luhatje të kërkesës ashtu edhe ndryshime në kriteret e përfitimit ose disponueshmërinë e fondeve.

Fondi aktual i strehimit social bashkiak përbëhet nga dy godina bashkiake të rehabilituara dhe një njësi modulare e ndërtuar rishtazi (me bazë kontenierësh), të gjitha të destinuara për strehim social me qira. Një zhvillim i rëndësishëm ka qenë transformimi i ish-konviktit të Shkollës së Pyjeve në strehim social për jetimët dhe familjet me një prind në vështirësi ekonomike. Një grup fillestar prej 16 përfituesish u miratua në vitin 2020, ndërsa 5 të tjerë u miratuan në vitin 2022. Pavarësisht këtyre shtesave, shqetësimet strukturore mbeten, përfshirë mirëmbajtjen e pamjaftueshme, aksesueshmërinë e kufizuar dhe eficiencën e ulët energjetike, veçanërisht në godinat më të vjetra të rehabilituara.

Privimi nga strehimi mbetet më i theksuar te komunitetet rome dhe egjiptiane. Bashkia ka identifikuar pesë vendbanime informale që strehojnë rreth 450 persona, prej të cilëve vetëm 33 familje (142 persona) janë të regjistruara zyrtarisht. Banorët shpesh jetojnë në struktura të përkohshme me akses të pamjaftueshëm në ujë, kanalizime dhe energji elektrike, dhe përballen me rreziqe të vazhdueshme si dëbimi, përmytjet dhe ekspozimi ndaj kushteve të pasigurta të jetesës. Për të zbutur këto problematika, Bashkia ka bashkëpunuar me organizata të shoqërisë civile, përfshirë edhe përmes qendrës komunitare “Për Familjen”, e cila lidh mbështetjen për strehimin me ndërhyrje psiko-sociale, arsimore dhe të punësimit.

Përfundim

Sinteza e dimensioneve demografike, sociale dhe rinore nxjerr në pah nevojën për një qasje holistike dhe shumësektoriale ndaj mbrojtjes sociale në Shkodër. Të dhënat tregojnë se varfëria, aftësia e kufizuar, vulnerabiliteti i fëmijëve, plakja dhe përjashtimi i të rinjve janë të ndërlidhura dhe shpesh përforcojnë njëra-tjetrën. Trajtimi efektiv i këtyre çështjeve kërkon tejkalimin e fragmentarizimit sektorial dhe kalimin drejt planifikimit të integruar, ku politikat sociale, arsimore, të punësimit dhe të shëndetësisë funksionojnë në sinergji.

Bashkia ka hedhur themelet për një integrim të tillë përmes nismave të synuara, zgjerimit të shërbimeve të bazuara në komunitet, bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe lançimit të programeve të fokusuara te të rinjtë. Megjithatë, për të garantuar qëndrueshmërinë, këto përpjekje duhet të përfshihen në një plan vendor gjithëpërfshirës që lidh ofrimin e shërbimeve me rezultatet e përfshirjes sociale.


Bashkia Shkodër ndodhet në një pikë kyçe ku transformimi demografik, tranzicioni ekonomik dhe inovacioni social ndërthuren. Aftësia e saj për t’iu përgjigjur këtyre ndryshimeve, përmes qeverisjes së integruar, planifikimit gjithëpërfshirës dhe partneritetit me komunitetet, do të përcaktojë efektivitetin e Planit të saj të Mbrojtjes Sociale dhe, në fund, mirëqenien dhe kohezionin e qytetarëve të saj.

PJESA III: SHTYLLAT STRATEGJIKE

Plani i Mbrojtjes Sociale është i strukturuar rreth tre shtyllave strategjike të ndërlidhura, të cilat mishërojnë prioritetet kryesore të zhvillimit social të bashkisë.

Këto shtylla adresojnë, në mënyrë të integruar dhe koherente, nevojat e grupeve më vulnerabël brenda komunitetit. Secila shtyllë përcakton një drejtim të qartë veprimi, të përkufizuar përmes objektivave strategjike specifike, masave të synuara, përgjegjësi të përcaktuara dhe mekanizmeve të monitorimit të konceptuar për të garantuar qëndrueshmërinë dhe përmirësime të prekshme në jetën e qytetarëve të Shkodrës.

Qëllimi i përgjithshëm i planit është të përmirësojë përfshirjen sociale, mirëqenien dhe cilësinë e jetës për individët, familjet dhe të rinjtë në nevojë në territorin e Bashkisë Shkodër, përmes aksesit të barabartë në shërbime sociale cilësore, nëpërmjet tre shtyllave mbështetëse të procesit, siç paraqitet në diagramin më poshtë.



SHTYLLA I – Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror

Forca e një shoqërie matet nga mënyra se si ajo kujdeset për anëtarët e saj më vulnerabël. Në kuadër të kësaj shtylle të parë, Bashkia Shkodër synon të ndërtojë një sistem shërbimesh sociale gjithëpërfshirës dhe të integruar, i cili të jetë i aksesueshëm, cilësor dhe i qëndrueshëm. Fokusi është shtrirja e shërbimeve të gjithë qytetarët, përfshirë ata në zonat rurale dhe të largëta, si dhe siguri i përfshirjes së synuar për komunitetet rome dhe egjiptiane. Përmes forcimit të kapaciteteve vendore dhe koordinimit, bashkia synon të krijojë një rrjet shërbimesh sociale të drejtë dhe efikas, të ndërtuar mbi nevojat e komunitetit.

Bashkia Shkodër do të ketë prioritet mirëmbajtjen, konsolidimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale ekzistuese, duke avancuar njëkohësisht tranzicionin drejt kujdesit me bazë komunitare dhe të përqendruar te individ. Kjo përfshin sigurimin e financimit të qëndrueshëm, rritjen e kapaciteteve të stafit dhe forcimin e strukturave si **Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVRN)**, për të garantuar identifikimin e hershëm të nevojave dhe një reagim efektiv në nivel vendor. Përmes këtyre përpjekjeve, Shkodra do të ofrojë mbështetje më pranë qytetarëve, do të promovojë dinjitetin dhe përfshirjen, si dhe do të sigurojë që të gjithë banorët të kenë akses në ndihmën që u nevojitet brenda komuniteteve të tyre.

Për realizimin e kësaj shtylle, Bashkia Shkodër angazhohet të ndërmarrë një sërë veprimesh të koordinuara që synojnë forcimin dhe zhvillimin e sistemit vendor të kujdesit shoqëror, konkretisht:

- të garantojë funksionimin e pandërprerë të të gjitha shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel bashkie;
- të sigurojë përputhshmërinë e shërbimeve sociale vendore me normat kombëtare të cilësisë dhe kriteret e akreditimit;
- të arrijë një nivel kënaqësie prej të paktën 75% të përdoruesve për të gjitha shërbimet sociale të financuara nga bashkia;
- të zhvillojë dhe zgjerojë shërbime kujdesi në shtëpi dhe shërbime të bazuara në komunitet për të moshuarit, duke promovuar dinjitetin, autonominë dhe jetesën e pavarur;
- të mbështesë dhe lehtësojë procesin e deinstitutionalizimit të fëmijëve, përmes vendosjes së tyre në kujdes familjar ose në forma alternative të përshtatshme kujdesi;
- të mundësojë aksesin e personave me aftësi të kufizuara në shërbime sociale të reja ose të zgjeruara, të orientuara drejt përfshirjes sociale dhe rritjes së pavarësisë;
- të sigurojë që të paktën 85% e popullsisë në nevojë të ketë akses në të paktën një shërbim social vendor ose të bazuar në komunitet, të ndarë sipas grupeve vulnerabël dhe zonave gjeografike;

- të menaxhojë rastet e kujdesit shoqëror përmes një qasjeje të integruar dhe shumësektoriale të menaxhimit të rasteve, me qëllim forcimin e koordinimit institucional dhe reagimit efektiv;
- të garantojë që 100% e rasteve të kujdesit shoqëror të regjistrohen dhe të menaxhohen përmes **Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror**, duke rritur eficiencën, transparencën dhe kapacitetet e monitorimit.

Bashkia Shkodër, përmes Drejtorisë së Përgjithshme Sociale dhe Rinisë, do të udhëheqë zbatimin në bashkëpunim të ngushtë me **Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, njësitë administrative, organizatat e shoqërisë civile, partnerët donatorë dhe institucionet e sektorëve të drejtësisë, policisë, arsimit dhe shëndetësisë. Së bashku, ata do të formojnë një rrjet të ndërlidhur të përkushtuar ndaj mirëqenies sociale dhe përfshirjes.

PRIORITETI 1: Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror ekzistuese

Specifike objektivi 1.1: Garantimi i vazhdimësisë së funksionimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror ekzistues.

- ✓ Hartimi dhe zbatimi i një plani vjetor për mbështetjen, koston dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror në nivel vendor, duke siguruar që të gjitha shërbimet të jenë të buxhetuara dhe të integruara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).
- ✓ Rinegociimi dhe konsolidimi i marrëveshjeve ekzistuese me partnerë të jashtëm për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, përmes kalimit drejt marrëveshjeve shumëvjeçare të financimit, të lidhura me standardet e cilësisë dhe indikatorët e performancës.
- ✓ Garantimi i financimit të qëndrueshëm për të gjitha shërbimet e kujdesit shoqëror në administrim ose financim bashkiak, përfshirë qendrat komunitare, shërbimet rezidenciale dhe zhvillimore, si dhe strukturat e reagimit emergjent.
- ✓ Ruajtja dhe sigurimi i fondeve të bashkisë për programet që promovojnë përfshirjen sociale dhe mbështesin grupet në nevojë.
- ✓ Organizimi i takimeve vjetore koordinuese me institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët donatorë, me qëllim monitorimin e progresit të shërbimeve ekzistuese dhe identifikimin e prioriteteve për mbështetje shtesë ose ndërhyrje emergjente.

Specifike objektivi 1.2: Mbështetja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- ✓ Organizimi i programeve të rregullta të trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve për drejtimin dhe stafin e shërbimeve të kujdesit shoqëror të financuara nga bashkia dhe donatorë, me qëllim forcimin e kompetencave profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

- ✓ Organizimi i punëtorive tematike për menaxhmentin dhe stafin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për të nxitur shkëmbimin e njohurive, inovacionin dhe adoptimin e praktikave më të mira në të gjitha shërbimet bashkiake.

Specifike Objektivi 1.3: Mbështetja e ofrimit të shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror dhe inovative.

- ✓ Kryerja e misionëve të rregullta të monitorimit për shërbimet e kujdesit shoqëror të financuara nga bashkia, me qëllim garantimin e llogaridhënies, cilësisë së shërbimit dhe përputhshmërisë me objektivat e politikave sociale vendore.
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i një udhëzuesi bashkiak për identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen e nevojave të fëmijëve nga komunitetet rome dhe egjiptiane, duke siguruar përdorimin e tij të unifikuar në të gjitha shërbimet e orientuara drejt fëmijëve.
- ✓ Krijimi i një partneriteti institucional me Departamentin e Punës Sociale të Universitetit të Shkodrës, për identifikimin, dokumentimin dhe promovimin e praktikave të mira në punën sociale, me synim zbatimin e tyre në nivel lokal.

Prioriteti 2: Zhvillimi dhe zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për grupet në nevojë

Specifike objektivi 2.1: Identifikimi i boshllëqeve territoriale dhe funksionale në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe planifikimi i zgjerimit të tyre.

- ✓ Mbajtja e një harte të përditësuar të të gjitha shërbimeve të kujdesit shoqëror të ofruara në territorin e bashkisë, përfshirë edhe ato që nuk financohen nga bashkia, si dhe rishikimi i saj në baza vjetore për të garantuar saktësinë dhe plotësinë e informacionit.
- ✓ Kryerja e një rishikimi afatmesëm përmes vlerësimeve të drejtpërdrejta dhe konsultimeve me komunitetin, me qëllim identifikimin e boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve dhe të nevojave të reja të grupeve vulnerabël.
- ✓ Bazuar në gjetjet e rishikimit afatmesëm, përgatitja e një plani zgjerimi të shërbimeve të kujdesit shoqëror, i cili përshkruan shërbime shtesë për menaxhim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Specifike objektivi 2.2: Krijimi i shërbimeve të reja bazuar në nevojat e identifikuar.

- ✓ Zhvillimi i një shërbimi të kujdesit në shtëpi për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, me qëllim ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes së personalizuar drejtpërdrejt në komunitet.
- ✓ Zhvillimi i një shërbimi të ri të kujdesit ditë për të moshuarit, për të nxitur ndërveprimin social, përfshirjen dhe mbështetjen e përditshme për qytetarët e moshuar.

- ✓ Krijimi i një qendre të re shumëfunksionale komunitare, e cila do të shërbejë për ofrimin e shërbimeve të bazuara në komunitet për personat me aftësi të kufizuara.
- ✓ Organizimi i një shërbimi socio-mjekësor (autobus socio-mjekësor) për të rinjtë dhe gratë, me qëllim përmirësimin e aksesit në shërbime shëndetësore, këshillimore dhe të kujdesit shoqëror, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.
- ✓ Eksplorimi i mundësive për kontraktimin e disa shërbimeve përmes palëve të treta, me qëllim garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe menaxhimit efikas të shërbimeve.
- ✓ Organizimi i procesit të rekrutimit dhe trajnimit të stafit për shërbimet e reja të menaxhuara drejtpërdrejt nga bashkia, për të garantuar ofrimin e shërbimeve profesionale dhe me cilësi të lartë.
- ✓ Përgatitja e strukturave të akomodimit emergjent për familjet në rast fatkeqësish natyrore, me qëllim sigurimin e reagimit të shpejtë dhe mbrojtjes së familjeve vulnerabël.

Specifike objektivi 2.3: Mbështetje në krijimin e shërbimeve alternative për fëmijët pa kujdes prindëror në kuadër të deinstitutionalizimit.

- ✓ Pilotimi i shërbimeve alternative për fëmijët e moshës 0–5 vjeç, përfshirë qendrat e emergjencës, shërbimet ditore dhe orientimin drejt formave të kujdesit alternativ, si dhe monitorimi i zbatimit përmes raportimit të rregullt.
- ✓ Zbatimi i programeve pilot të kujdesit alternativ për fëmijët e moshës 6–15 vjeç, duke siguruar përfshirjen e fëmijëve të identifikuar dhe vlerësimin e vazhdueshëm përmes raporteve të monitorimit.
- ✓ Promovimi i rekrutimit të familjeve kujdestare përmes fushatave të synuara të komunikimit dhe ndërgjegjësimit.

Specifike Objektivi 2.4: Përmirësimi i aksesueshmërisë për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

- ✓ Lehtësimi i transportit social për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, bazuar në studime fizibiliteti dhe plane financimi të miratuara, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit në rastet kur kontraktimi i jashtëm identifikohet si qasja më efektive.
- ✓ Ndërtimi ose rehabilitimi i trotuareve, rampave, sinjalistikës dhe ndërtesave publike, në përputhje me standardet kombëtare të aksesueshmërisë.

Specifike Objektivi 2.5: Përmirësimi i përfshirjes sociale dhe ekonomike të komuniteteve rome dhe egjiptiane.

- ✓ Sigurimi i regjistrimit të anëtarëve të identifikuar të komuniteteve rome dhe egjiptiane në skemat e shëndetit publik dhe të mbrojtjes sociale.
- ✓ Identifikimi dhe mbështetja e fëmijëve nga komunitetet rome dhe egjiptiane që ndodhen në situatë rruge, përmes skuadrave të terrenit.

- ✓ Zhvillimi i fushatave kundër diskriminimit dhe promovimin e përfshirjes sociale, të orientuara drejt komunitetit, veçanërisht komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Specifike Objektivi 2.6: Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimit social e ekonomik të grave në komunitet, veçanërisht atyre në zonat rurale.

- ✓ Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe depistimit për shëndetin riprodhues, kancerin e gjirit dhe të qafës së mitrës, shëndetin mendor dhe promovimin e stileve të shëndetshme të jetesës.
- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse përmes zhvillimit të programeve të dedikuara për leadershipin dhe angazhimin qytetar.
- ✓ Zbatimi i programeve të fuqizimit për gratë e papuna, nënat beqare, gratë nga komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe gratë që jetojnë në varfëri, me qëllim rritjen e përfshirjes sociale dhe pavarësisë ekonomike.

Prioriteti 3: Forcimi i mekanizmave lokalë për një mbrojtje sociale efektive dhe të integruar.

Specifike Objektivi 3.1: Krijimi dhe aktivizimi i Njesisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NVNR).

- ✓ Zhvillimi dhe miratimi i strukturës organizative të NVNR-së, duke siguruar përcaktimin e qartë të roleve, përgjegjësi dhe linjave të koordinimit për ofrimin efektiv të shërbimeve.
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i një protokollit operativ për funksionimin e NVNR-së, i cili përcakton procedura të qarta për menaxhimin e rasteve dhe garanton funksionimin efikas të njesisë në përputhje me standardet bashkiake dhe kuadrin ligjor në fuqi.
- ✓ Përzgjedhja dhe rekrutimi i stafit të kualifikuar për NVNR-në, në përputhje me strukturën organizative të miratuar, me qëllim sigurimin e kapaciteteve të plota për menaxhimin efektiv të rasteve të kujdesit shoqëror.

Specifike Objektivi 3.2: Zbatimi dhe funksionimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror

- ✓ Instalimi dhe funksionalizimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në të gjitha strukturat përkatëse të bashkisë, për të garantuar menaxhim të unifikuar, efikas dhe transparent të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- ✓ Ofrimi i trajnimeve gjithëpërfshirëse për stafin bashkiak mbi përdorimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, përfshirë trajnime rifreskuese, me qëllim ndërtimin e kompetencave digjitale dhe shfrytëzimin efektiv të platformës.

- ✓ Kalimi i plotë në menaxhimin digjital të rasteve, duke garantuar që të gjitha rastet e kujdesit shoqëror të administruara nga bashkia të regjistrohen, gjurmohen dhe përditësohen në mënyrë sistematike në Regjistrin Elektronik Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror.

Specifike objektivi 3.3 Forcimi i funksionimit të strukturës aktuale për monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror..

- ✓ Zhvillimi dhe miratimi i përshkrimeve të vendeve të punës për pozicione të specializuara në monitorimin dhe planifikimin social, si dhe rekrutimi i stafit të kualifikuar për të forcuar vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen e bazuar në prova.
- ✓ Përditësimi dhe formalizimi i strukturës organizative për monitorimin, duke siguruar role dhe përgjegjësi të qarta për planifikimin, koordinimin dhe ndjekjen e performancës së shërbimeve në nivel bashkie.
- ✓ Organizimi i cikleve të rregullta të trajnimit për stafin bashkiak, në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe partnerët teknikë, për të rritur kapacitetet profesionale në monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- ✓ Rishikimi dhe zbatimi i instrumenteve dhe indikatorëve të monitorimit, në përputhje me praktikat më të mira dhe nevojat në zhvillim të bashkisë, duke garantuar mbledhjen e saktë, të plotë dhe të krahasueshme të të dhënave.
- ✓ Hartimi dhe prezantimi i një raporti vjetor të monitorimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, i përgatitur në mënyrë sistematike dhe i paraqitur për shqyrtim nga drejtuesit, për të mbështetur planifikimin strategjik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

Specifike objektivi 3.4: Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe bashkëpunimit ndërinstitutional për menaxhimin e rasteve.

- ✓ Organizimi i cikleve të trajnimit tematik për stafin bashkiak mbi qasjet e integruara, menaxhimin e rasteve, etikën profesionale dhe procedurat e referimit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit shumëdisiplinor dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.
- ✓ Ofrimi i trajnimeve të specializuara për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik brenda sistemit arsimor, në bashkëpunim me strukturat vendore të arsimit, për të garantuar identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjen e koordinuar.
- ✓ Zbatimi i trajnimeve të synuara për menaxhimin e rasteve të punëkërkuarve, në bashkëpunim me zyrat vendore të punësimit, për të forcuar mbështetjen e integruar dhe rrugët drejt punësimit të qëndrueshëm.
- ✓ Ofrimi i trajnimeve të specializuara për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge, në bashkëpunim me institucionet e arsimit, shëndetësisë dhe të zbatimit të ligjit, për të garantuar mbrojtje dhe riintegrim efektiv.
- ✓ Organizimi i trajnimeve specifike për menaxhimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje, në partneritet me sektorin e shëndetësisë dhe Policinë e Shtetit, për të siguruar një reagim të koordinuar dhe të përqendruar të mbijetuarit.
- ✓ Mbështetja e formalizimit profesional dhe licencimit të punonjësve socialë dhe psikologëve, duke garantuar anëtarësimin e tyre në Urdhrin e Punonjësve Socialë dhe Psikologëve, në përputhje me standardet kombëtare.

- ✓ Organizimi i trajnimeve të dedikuara për stafin bashkiak mbi identifikimin dhe adresimin e pengesave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Specifike objektivi 3.5: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në menaxhimin e rasteve.

- ✓ Zbatimi i marrëveshjeve ndërsektoriale me sektorët e arsimit, shëndetësisë, punësimit dhe drejtësisë, për të forcuar koordinimin dhe për të garantuar përgjigje të integruara ndaj nevojave sociale, përmes takimeve të rregullta të përbashkëta dhe veprimeve pasuese.
- ✓ Sigurimi i zbatimit dhe monitorimit efektiv të mekanizmit ndërinstitucional të menaxhimit të rasteve, me qëllim garantimin e mbështetjes së koordinuar për rastet që kërkojnë ndërhyrje dhe ndjekje shumësektoriale.

Specifike objektivi 3.6: Vendosja e një dialogu të vazhdueshëm me publikun, shoqërinë civile dhe partnerët e zhvillimit.

- ✓ Organizimi i konsultimeve publike dhe grupeve të fokusit me përfaqësues të komunitetit, për të garantuar dialog gjithëpërfshirës mbi çështjet sociale, me vëmendje të veçantë për pjesëmarrjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane.
- ✓ Zhvillimi i takimeve konsultative me aktorët e shoqërisë civile dhe institucionet publike, për të identifikuar prioritetet të përbashkëta dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërsektorial në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- ✓ Angazhimi i ndërmjetësuesve komunitarë për informimin, orientimin dhe mbështetjen e anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane në aksesin në shërbimet bashkiake ekzistuese dhe të sapokrijuara.

Specifike objektivi 3.7: Forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit me bashkitë fqinje në kuadër të iniciativave ndërbashkiake.

- ✓ Pjesëmarrja aktive në hartimin dhe zbatimin e Planit Social Rajonal për Qarkun e Shkodrës, me qëllim sigurimin e planifikimit të koordinuar dhe integrimin e prioritetëve bashkiake në kuadrin rajonal.
- ✓ Vlerësimi dhe forcimi i bashkëpunimit ndërbashkiak në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, përmes dialogut të rregullt dhe nismave të përbashkëta, duke përfshirë eksplorimin e modeleve të ofrimit ndërbashkiak të shërbimeve për rritjen e efikasitetit dhe shtrirjes territoriale.

SHTYLLA II – Pjesëmarrja aktive e të rinjve në shoqëri

Të rinjtë janë forca shtytëse e së ardhmes së Shkodrës (energji, krijimtaria dhe inovacioni) që do të përcaktojnë progresin e qytetit në vitet në vijim. Kjo shtyllë i njeh të

rinjtë jo si përfitues pasivë, por si partnerë aktivë në formësimin e transformimit social dhe ekonomik të Shkodrës. Bashkia Shkodër është e vendosur të forcojë politikat dhe programet që synojnë garantimin e pjesëmarrjes së tyre sociale, ekonomike dhe qytetare, me theks të veçantë te të rinjtë në rrezik përjashtimi.

Duke u mbështetur në Këshillin Vendor Rinor, bashkia do të forcojë zërin e të rinjve në hartimin e politikave dhe do të sigurojë që idetë e tyre të ndikojnë drejtpërdrejt vendimmarrjen për të ardhmen e qytetit. Si bashki pilote për Garancinë Rinore në Shqipëri, Shkodra do të promovojë partneritete më të forta me institucionet e arsimit profesional dhe punësimit, për të lidhur të rinjtë me mundësi domethënëse dhe të qëndrueshme. Sipërmarrja dhe inovacioni do të nxiten si motorë të rritjes, ndërsa arsimi joformal dhe vullnetarizmi do të jenë elementë kyç për nxitjen e lidershit, përgjegjësisë qytetare dhe frymës komunitare. Përmes investimeve në kulturë, sport dhe hapësira krijuese, bashkia riafirmon bindjen se fuqizimi i të rinjve nuk është vetëm një investim te individët, por një investim në vetë të ardhmen e Shkodrës.

Për realizimin e kësaj shtylle, bashkia angazhohet të:

- Fuqizojë 20.000 të rinj për të përfituar nga ambiente moderne, gjithëpërfshirëse dhe frymëzuese arsimore dhe rinore, që mishërojnë vizionin e bashkisë për një brez energjik dhe të orientuar drejt së ardhmes.
- Punojë për të siguruar që 50% e të rinjve në komunitet të ndihen më të aftë, më të sigurt dhe më të mbështetur në realizimin e ambicieve të tyre përmes programeve dhe nismave bashkiake.
- Mbështesë krijimin e 40 sipërmarrjeve rinore ose start-up-eve, duke promovuar inovacionin, sipërmarrjen dhe rolin aktiv të të rinjve në zhvillimin social dhe ekonomik të Shkodrës.
- Synojë që 40% e të rinjve pjesëmarrës të ndihen se zëri i tyre reflektohet në proceset vendimmarrëse bashkiake dhe në politikat që formësojnë të ardhmen e qytetit.

Bashkia Shkodër, përmes Sektorit të Rinisë, do të udhëheqë zbatimin e kësaj shtylle në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Vendor Rinor, organizatat rinore dhe institucionet arsimore, përfshirë Qendrën Rinore "Atelie". Bashkëpunimi me partnerët e zhvillimit, programet e donatorëve dhe rrjetet kombëtare rinore do të sigurojë akses në burime, ekspertizë dhe praktika inovative.

PRIORITETI 4: Infrastrukturë cilësore për të rinjtë, brenda dhe jashtë shkollës

Specifike objektivi 4.1 Sigurimi i infrastrukturës cilësore brenda shkollave

- ✓ Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës shkollore, me fokus në aksesueshmërinë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe restaurimin e laboratorëve funksionalë shkollore të pajisur me materiale të përditësuara.

- ✓ Përfshirja e infrastrukturës digjitale, lidhjes në internet dhe elementëve të aksesueshmërisë.
- ✓ Krijimi i hapësirave bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse brenda shkollave, si biblioteka dhe ambiente sociale, për të nxitur të nxënit, ndërveprimin dhe angazhimin komunitar.
- ✓ Pajisja e shkollave të mesme me paketa multimediale, përfshirë projektorë, ekrane dhe sisteme audio, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit

Specifike Objektivi 4.2 Përmirësimi i hapësirave të sigurt rinore që garantojnë zhvillimin e aktiviteteve të edukimit joformal.

- ✓ Realizimi i një studimi fizibiliteti për zhvillimin e hapësirave të reja të sigurt rinore, duke përfshirë një plan financimi që të orientojë investimet e ardhshme.
- ✓ Projektimi i një hapësire të re të sigurt rinore ose qendre komunitare me komponentë administrativë, kulturorë dhe sportivë, si dhe vlerësimi i mundësisë që menaxhimi i qendrës të delegohet (outsourcing) si opsioni më efektiv.
- ✓ Mirëmbajtja dhe përditësimi i Qendrës Rinore ekzistuese “Atelie”, për të siguruar që ajo të mbetet e sigurt, e aksesueshme dhe plotësisht funksionale për të rinjtë.

PRIORITETI 5: Të rinj inovativë, krijues dhe të shëndetshëm

Specifike objektivi 5. Mbështetja dhe promovimi i kulturës, historisë dhe sportit tek të rinjtë

- ✓ Organizimi i konkurseve në artet pamore, sport, teatër dhe shkrim krijues për të nxitur krijimtarinë, vetëshprehjen dhe stilin e shëndetshëm të jetesës të të rinjtë (si p.sh. Festivali Youth Wave).
- ✓ Zbatimi i një fushate ndërgjegjësuere për të motivuar të rinjtë të ndjekin rrugë profesionale të lidhura me traditat, kulturën dhe nevojat ekonomike të rajonit.
- ✓ Zhvillimi i një programi të arsimit joformal që promovon njohjen e historisë lokale, përfshirë përvojat dhe pasojat e regjimit komunist në rajon, me qëllim forcimin e të kuptuarit historik dhe ndërgjegjësimit qytetar të të rinjtë.

Specifike objektivi 5.2 Mbështetja e zbatimit të Garancisë Rinore përmes parandalimit të braktisjes së shkollës

- ✓ Organizimi i aktiviteteve që identifikojnë dhe promovojnë të rinjtë e talentuar në shkollat e mesme, duke u ofruar atyre mundësi për të prezantuar arritjet e tyre dhe duke nxitur ekselencën mes bashkëmoshatarëve.
- ✓ Zbatimi i nismave parandaluese për të rinjtë në rrezik të braktisjes së shkollës, me fokus në ndërgjegjësim, ndërhyrje të hershme dhe masa mbështetëse për përmirësimin e vijueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në shkollë.

- ✓ Zhvillimi i një strategjie të synuar, në partneritet me Zyrën Vendore të Arsimit dhe shkollat, për të parandaluar braktisjen e hershme shkollore të fëmijët nga komunitetet rom dhe egjiptian dhe për të mbështetur përfshirjen e tyre arsimore.
- ✓ Zhvillimi i seancave orientuese për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale, për t'i udhëzuar ata në marrjen e vendimeve të informuara akademike dhe profesionale për rrugët e tyre të ardhshme.
- ✓ Zbatimi i Kartës së Studentit si një instrument përmes të cilit nxënësit mund të përfitojnë një sërë lehtësish, tarifa të reduktuara dhe oferta të dedikuara, të ofruara si nga institucionet publike ashtu edhe nga subjektet private.
- ✓ Lehtësimi i transportit për kursantët e arsimit profesional, gratë dhe të rinjtë nga zonat rurale dhe grupet vulnerabël, për të garantuar pjesëmarrjen e tyre të rregullt në programet e arsimit dhe formimit profesional.

Specifike objektivi 5.3 Mbështetja e zbatimit të Garancisë për të Rinjtë përmes krijimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave dhe programeve që promovojnë sipërmarrjen dhe inovacionin të të rinjtë

- ✓ Rinovimi dhe forcimi i portalit *shkodrarinore.gov.al*, duke siguruar përditësimin e rregullt të informacionit mbi punësimin, sipërmarrjen dhe nismat vendore, me qëllim pozicionimin e tij si një platformë kyçe lokale për angazhimin dhe mundësitë për të rinjtë.
- ✓ Organizimi i trajnimeve të synuara për të rinjtë, në partneritet me zyrat vendore të punësimit dhe qendrat e formimit profesional, me fokus në aspektet ligjore, financiare dhe menaxheriale të drejtimit të një biznesi.
- ✓ Organizimi i panairëve të punës dhe karrierës në bashkëpunim me zyrat vendore të punësimit, për të lidhur të rinjtë punëkërkues me punëdhënësit dhe për të promovuar mundësitë e punësimit lokal.
- ✓ Hapja e një konkursi për sipërmarrje për të mbështetur ndërmarrjet dhe agrobizneset e drejtuara nga të rinjtë, duke nxitur inovacionin dhe vetëpunësimin.
- ✓ Zhvillimi i një qendre lokale të sipërmarrjes ose një hapësire të përbashkët pune (coworking) për të mbështetur sipërmarrësit e rinj përmes infrastrukturës së përbashkët, mentorimit dhe mundësive për rrjetëzim, si dhe, bazuar në rezultatet e studimit të fizibilitetit, zbatimi i procedurave të prokurimit nëse delegimi i menaxhimit (outsourcing) vlerësohet si qasja më efektive.

Specifike objektivi 5.4 Mbështetja e të rinjve për të ndjekur stile jetese të shëndetshme dhe të sigurta

- ✓ Ofrimi i kontrolleve shëndetësore vjetore falas për të rinjtë, me qëllim promovimin e kujdesit shëndetësor parandalues dhe zbulimin e hershëm të problematikave shëndetësore të popullata e re.
- ✓ Përmirësimi i gjendjes dhe aksesueshmërisë së ambienteve dhe fushave sportive për të nxitur aktivitetin fizik, mirëqenien dhe përfshirjen sociale përmes sportit.

- ✓ Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese në shkolla mbi bullizmin, në partneritet me Zyrën Vendore të Arsimit, për të krijuar mjedise të sigurta dhe gjithëpërfshirëse të të nxëniet.
- ✓ Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme, në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit dhe autoritetet shëndetësore, për të promovuar sjellje të informuara dhe të përgjegjshme te të rinjtë.
- ✓ Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi varësinë nga droga dhe alkooli, në partneritet me Zyrën Vendore të Arsimit dhe autoritetet shëndetësore, për të parandaluar abuzimin me substanca dhe për të mbështetur stile jetese të shëndetshme.
- ✓ Ofrimi i programeve për shëndetin mendor të të rinjve, që sigurojnë mbështetje psikologjike, këshillim dhe aktivitete ndërgjegjësuese, me qëllim promovimin e mirëqenies emocionale dhe qëndrueshmërisë psikologjike te të rinjtë.

PRIORITETI 6 Të rinj të angazhuar dhe pjesëmarrës aktivë në komunitet

Specifike objektivi 6.1 Forcimi i rolit të të rinjve në vendimmarrjen dhe përfaqësimin lokal.

- ✓ Forcimi i kapaciteteve të Këshillit Vendor Rinor përmes ofrimit të sesioneve të rregullta trajnuese dhe mbështetjes së pjesëmarrjes aktive, takimeve dhe shkëmbimeve të shpeshta.
- ✓ Mbështetja e krijimit të qeverive studentore në shkollat e mesme publike dhe në universitete, me qëllim promovimin e përfaqësimit rinor dhe pjesëmarrjes demokratike brenda institucioneve arsimore.
- ✓ Ofrimi i trajnimeve për stafin e shkollave dhe universiteteve, në bashkëpunim me Zyrat Vendore të Arsimit, për të rritur mirëkuptimin mbi rëndësinë e përfaqësimit rinor dhe qeverisjes pjesëmarrëse.
- ✓ Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi barazinë gjinore, duke promovuar përfshirjen dhe leadershipin e vajzave dhe grave të reja në proceset vendimmarrëse, si në nivel vendor ashtu edhe institucional.

Specifike objektivi 6.2 Nxitja e dialogut të organizuar ndërmjet të rinjve dhe institucioneve publike në nivel bashkie

- ✓ Mbështetja e aktiviteteve të Këshillit Vendor Rinor përmes ofrimit të hapësirave dhe mundësive për angazhim.
- ✓ Organizimi i takimeve të rregullta publike (town hall) me të rinjtë, përfshirë edhe zonat rurale, për të krijuar një platformë të hapur dialogu, feedback-u dhe shkëmbimi mbi shërbimet dhe nismat që synojnë të rinjtë brenda bashkisë.
- ✓ Lehtësimi i takimeve ndërmjet të rinjve dhe strukturave të qeverisë qendrore, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe sigurimin që politikat dhe programet kombëtare për rininë të reflektojnë realitetet dhe prioritetet vendore.

- ✓ Festimi çdo vit i Javës së Demokracisë Rinore përmes eventeve dhe aktiviteteve që promovojnë dialogun mbi politikat rinore, pjesëmarrjen qytetare dhe rolin e të rinjve në formësimin e vendimmarrjes institucionale.

Specifike objektivi 6.3 Nxitja dhe përkrahja e grupeve dhe organizatave rinore në komunitet

- ✓ Krijimi dhe mirëmbajtja e një databaze të përditësuar të organizatave të drejtuara nga të rinjtë dhe atyre të fokusuara te rinia që veprojnë brenda bashkisë, për të forcuar koordinimin, dukshmërinë dhe bashkëpunimin mes aktorëve rinorë.
- ✓ Ofrimi i granteve vjetore për projekte të drejtuara nga të rinjtë që promovojnë angazhimin komunitar, inovacionin dhe qytetarinë aktive.
- ✓ Zbatimi i programeve për ndërtimin e kapaciteteve për liderët dhe organizatat rinore, me qëllim forcimin e aftësive drejtuese dhe promovimin e pjesëmarrjes efektive të të rinjve në zhvillimin vendor.
- ✓ Mbështetja e organizatave rinore në zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale për funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të organizatave jofitimprurëse.
- ✓ Përmirësimi i aftësive të organizatave rinore në mbledhjen e fondeve, menaxhimin e projekteve dhe shkrimin e propozimeve, për të rritur aksesin në financime dhe kapacitetin e zbatimit të projekteve.
- ✓ Organizimi i një panairi vjetor rinor në Ditën Kombëtare të Rinisë, që bashkon organizata rinore, grupe informale dhe Këshillin Vendor Rinor, për të nxitur rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira.
- ✓ Lehtësimi i shkëmbimeve rinore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të nxitur të nxënit ndërkulturor dhe për të zgjeruar mundësitë për zhvillim personal dhe profesional.
- ✓ Zbatimi i fushatave ndërgjegjësuere ndërmjet të rinjve dhe organizatave rinore për të theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes në proceset zgjedhore dhe për të inkurajuar angazhimin aktiv të votuesve të rinj.

Specifike objektivi 6.4 Mbështetja dhe promovimi i punonjësve rinorë dhe vullnetarëve

- ✓ Ofrimi i praktikave profesionale gjashtëmujore brenda bashkisë për t'u mundësuar të rinjve përvojë praktike në administratën vendore dhe për të forcuar njohuritë e tyre mbi qeverisjen publike.
- ✓ Organizimi i një kampi veror vjetor të dedikuar mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të vullnetarizmit të rinjtë.
- ✓ Zbatimi i një programi për ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve rinorë, me qëllim rritjen e njohurive, aftësive dhe kapacitetit të tyre për t'u angazhuar në mënyrë efektive me të rinjtë në komunitet.
- ✓ Lehtësimi i mundësive të praktikës profesionale për punonjësit rinorë brenda strukturave komunitare, për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional dhe të nxënës praktik.
- ✓ Promovimi i vullnetarizmit përmes aktiviteteve të rregullta të fokusuara në mbrojtjen e mjedisit, trashëgiminë kulturore, përfshirjen sociale dhe shëndetin dhe mirëqenien.
- ✓ Festimi çdo vit i Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit me evente publike që rrisin ndërgjegjësimin mbi vullnetarizmin rinor dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet të rinjve dhe institucioneve.
- ✓ Zhvillimi i një mekanizmi vlerësimi dhe njohjeje për pjesëmarrje qytetare dhe vullnetarizëm të spikatur.

SHTYLLA III – Strehimi Social

Strehimi social përbën një shtyllë kyçe të sistemit të mbrojtjes sociale dhe një instrument themelor për garantimin e kushteve të jetesës të përballueshme dhe dinjitoze për familjet në nevojë. Një nga sfidat e evidentuara si pasojë e pandemisë COVID-19 lidhej me përballueshmërinë dhe cilësinë e strehimit, si dhe me vështirësitë që shumë familje hasin për të siguruar banesa të sigurt dhe të përshtatshme. Si rrjedhojë, strehimi social është njohur si një levë transformimi, i nxitur nga nevoja për t'u përshtatur me zhvillimet më të gjera socio-ekonomike, ndryshimet demografike dhe dinamikat në ndryshim të tregut të banesave.

Për Bashkinë Shkodër, strehimi nuk është vetëm një çështje infrastrukture, por edhe një çështje e përfshirjes sociale, barazisë dhe stabilitetit afatgjatë të komunitetit. Një banesë e sigurt dhe dinjitoze përbën bazën për mirëqenien individuale, aksesin në arsim dhe punësim, si dhe pjesëmarrjen aktive në jetën komunitare. Në këtë kuadër, bashkia synon të ndërtojë një sistem strehimi gjithëpërfshirës dhe të drejtë, që i përgjigjet realiteteve të ndryshme të grupeve vulnerabël përmes një sërë programesh të përshtatura.

Për realizimin e kësaj shtylle, Bashkia Shkodër angazhohet të:

- Garantojë që çdo familje e kualifikuar të ketë akses real në strehimin social, duke siguruar që mbulimi të arrijë në 80% të të gjitha familjeve në nevojë.
- Udhëheqë një proces ambicioz zgjerimi dhe rehabilitimi për ndërtimin dhe rikonstruksionin e njësive të reja të strehimit social.

- Fuqizojë familjet përmes zgjerimit të aksesit në programe alternative, si subvencionet e qirasë, asistencë për përmirësimin e banesave dhe skemat e përshtatjes për aksesueshmëri, duke garantuar që 75% e familjeve të kualifikuara të përfitojnë nga mbështetja.

Bashkia Shkodër, e udhëhequr nga Sektori i Strehimit, do të bashkëpunojë me ministrinë përgjegjëse, si dhe me organizatat jofitimprurëse, donatorët, institucionet financiare dhe sektorin privat për zbatimin e kësaj shtylle.

PRIORITETI 7: Garantimi i mundësisë për strehim social për personat në nevojë

Specifike Objektivi 7.1: Përditësimi i vazhdueshëm i databazës mbi kërkesat për strehim social

- ✓ Identifikimi dhe analizimi i grupeve prioritare për strehimin social, bazuar në karakteristikat socio-ekonomike, duke siguruar që ndërhyrjet të jenë të orientuara drejt atyre që kanë më shumë nevojë dhe të mbështeten në konsultime publike.
- ✓ Zhvillimi i një databaze gjithëpërfshirëse që përmban informacion mbi grupet e identifikuara dhe kushtet e tyre të strehimit, me qëllim monitorimin e tendencave dhe parashikimin e ndryshimeve në kërkesën për strehim social.
- ✓ Mirëmbajtja dhe përditësimi i rregullt i databazës për të siguruar që politikat dhe planifikimi vendor të mbeten të bazuara në evidencë dhe t'u përgjigjen nevojave në zhvillim të komunitetit.

Specifike objektivi 7.2: Përditësimi dhe zgjerimi i përdorimit të regjistrit elektronik të aplikantëve për strehim social

- ✓ Sigurimi i mirëmbajtjes së rregullt dhe përmirësimit të sistemit elektronik për strehimin social, përfshirë hartimin e një manuali të qartë përdorimi dhe përditësimet e sistemit, për të garantuar efikasitet, saktësi dhe lehtësi në përdorim.
- ✓ Promovimi i transparencës dhe përmirësimit të orientuar drejt përdoruesit, përmes organizimit të konsultimeve publike dhe grupeve të fokusit, për të mbledhur feedback mbi sistemin elektronik dhe për të identifikuar mundësi për përmirësimin e funksionalitetit dhe kënaqësisë së përdoruesve.

Specifike objektivi 7.3: Lehtësimi i procedurave për aplikantët e programeve sociale

- ✓ Rivlerësimi i aplikantëve për strehim social përmes verifikimeve të rregullta në terren, për të siguruar që vendimmarrja të jetë e drejtë, transparente dhe me cilësi të lartë.
- ✓ Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së informacionit dhe orientimit të ofruar për aplikantët potencialë, për të garantuar që zgjidhjet e strehimit të ofruara të jenë të përshtatshme për nevojat individuale.
- ✓ Garantimi i një procesi ankese në kohë dhe efikas përmes sistemit elektronik/fizik të mekanizmit të ankesave, duke siguruar që të gjitha ankesat të trajtohen dhe zgjidhen brenda afateve të përcaktuara.

- ✓ Zbatimi i një fushate informuese dhe ndërgjegjësuere për të informuar qytetarët mbi procesin e aplikimit dhe përfitimet e strehimit social, e mbështetur nga materiale informuese të aksesueshme, të shpërndara në të gjithë territorin e bashkisë.

Specifike objektivi 7.4: Identifikimi i instrumentave financiare për strehim social

- ✓ Koordinimi dhe institucionalizimi i marrëveshjeve afatgjata me mekanizmat e financimit të qeverisë qendrore për të siguruar mbështetje financiare të qëndrueshme dhe të qëndrueshme për iniciativat e ardhshme të strehimit social.
- ✓ Identifikimi dhe vlerësimi i mundësive të financimit si për projektet aktuale, ashtu edhe për ato potenciale të strehimit social, me qëllim diversifikimin e burimeve financiare dhe forcimin e kapacitetit investues të bashkisë në sektorin e strehimit.

PRIORITETI 8: Zgjerimi i mundësive të strehimit social në gjithë territorin e bashkisë

Specifike objektivi 8.1: Realizimi një studimi vlerësues për zhvillimin e strehimit social

- ✓ Realizimi i një studimi fizibiliteti për zgjerimin e strehimit social, me qëllim identifikimin e nevojave prioritare, vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe hapësinore, si dhe orientimin e investimeve të ardhshme përmes konsultimeve të gjera publike.
- ✓ Zgjerimi i strehimit social në përputhje me objektivat e planifikimit vendor, duke siguruar që projektet e reja të ndërtimit t'u përgjigjen nevojave të identifikuar dhe të përfundojnë në mënyrë efikase dhe me standarde të larta cilësie.
- ✓ Zhvillimi dhe institucionalizimi i partneriteteve të qëndrueshme financiare me aktorë shtetërorë dhe joshetërorë, për të garantuar investime të vazhdueshme dhe koordinim për nismat e reja të strehimit social.
- ✓ Promovimi i bashkëpunimit me sektorin privat për të inkurajuar zhvillimin e modeleve të strehimit social të subvencionuara nga shteti dhe të menaxhuara nga subjekte private, të cilat plotësojnë përpjekjet publike dhe zgjerojnë alternativat e strehimit të përballeshëm.

Specifike Objektivi 8.2: Rritja e mundësive të strehimit përmes programeve të ndryshme

- ✓ Zhvillimi dhe zbatimi i një programi subvencionimi të qirasë, që ofron mbështetje financiare për individë dhe familje me të ardhura të ulëta, duke i ndihmuar të sigurojnë dhe të mbajnë një strehim të përshtatshëm dhe duke reduktuar rrezikun e dëbimit ose të mbetjes pa strehë.
- ✓ Krijimi i një programi për përmirësimin e banesave, i cili synon të mbështesë familjet vulnerabël në rikonstruksionin ose përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, në mënyrë që ato të përmbushin standardet minimale të jetesës, kërkesat e sigurisë dhe standardet e eficiencës energjetike.

- ✓ Krijimi i një programi për strehim të aksesueshëm, i projektuar për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit në realizimin e përshtatjeve të domosdoshme në banesat e tyre, si rampa, ashensorë ose banjo të përshtatura, për të garantuar kushte jetese të sigurt, dinjitoze dhe të pavarura.

Specifike Objektivi 8.3: Vlerësimi i aseteve shtetërore për mundësitë e transformimit të tyre në strehim social

- ✓ Hartëzimi dhe analizimi i aseteve shtetërore të papërdorura ose të nënshfrytëzuara, për të identifikuar prona që mund të transformohen në strehim social, duke maksimizuar përdorimin e burimeve publike ekzistuese në dobi të komunitetit.
- ✓ Vlerësimi i gjendjes dhe potencialit të pronave shtetërore për të përcaktuar se cilat prej tyre janë më të përshtatshme për rihvillim ose transformim në zgjidhje strehimi të përballueshme.
- ✓ Zhvillimi i një plani të plotë fizibiliteti dhe investimi për transformimin e aseteve shtetërore të përzgjedhura në strehim social, në koordinim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse, për të siguruar përputhjen me prioritetet kombëtare të strehimit.

Specifike objektivi 8.4: Rritja e kapaciteteve të stafit në sektorin e strehimit

- ✓ Forcimi i kapaciteteve të stafit të strehimit, përgjegjës për menaxhimin e aplikimeve për strehim social, përmes rritjes së njohurive dhe aftësive në përdorimin e sistemit elektronik të aplikimit dhe menaxhimit, në mënyrë efektive dhe transparente.
- ✓ Përmirësimi i kompetencave të stafit në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave që lidhen me strehimin social dhe karakteristikat socio-ekonomike, duke mundësuar vendimmarrje të bazuar në evidencë dhe duke përmirësuar orientimin e masave mbështetëse.

PJESA IV: STRATEGJIA E MONITORIMIT DHE KOMUNIKIMIT

Monitorimi dhe treguesit

Zbatimi i Planit të Mbrojtjes Sociale do të udhëhiqet nga një kuadër gjithëpërfshirës monitorimi, i projektuar për të matur progresin, për të garantuar llogaridhënie dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë. Për secilën shtyllë strategjike, objektivat specifike janë të lidhura me tregues të matshëm dhe aktivitete përkatëse, të detajuara në aneks.

Për krijimin e një baze fillestare për treguesit, në fillim të vitit 2026 do të realizohet një studim i shkurtër, me qëllim përcaktimin e baseline-it dhe konfirmimin e objektivave për vitin 2030.

Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë do të koordinojë procesin e monitorimit në bashkëpunim me sektorët përkatës bashkiakë përgjegjës për shërbimet sociale, rininë dhe strehimin. Secili sektor do të mbledhë dhe raportojë të dhëna në përputhje me metodologjitë dhe afatet e dakordësuara. Raportet e konsoliduara të progresit do të shqyrtohen nga ekipi drejtues i bashkisë dhe do t'i paraqiten Këshillit Bashkiak, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie institucionale.

Monitorimi do të integrohet ngushtë me raportet vjetore të performancës së bashkisë dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), duke harmonizuar ciklet e planifikimit, buxhetimit dhe raportimit. Rishikimet e rregullta të progresit do të vlerësojnë statusin e zbatimit, do të identifikojnë sfidat dhe do të propozojnë masa korrigjuese.

Për të ruajtur aktualitetin dhe qëndrueshmërinë e planit, sistemi i monitorimit do të mbetet fleksibël, duke mundësuar përshtatje në kohë ndaj nevojave në zhvillim, rrethanave të paparashikuara apo goditjeve të jashtme që mund të ndikojnë në zbatim.

Në përfundim të periudhës së planit do të realizohet një vlerësim përfundimtar, me qëllim vlerësimin e arritjeve të përgjithshme, matjen e ndikimit afatgjatë të ndërhyrjeve dhe nxjerrjen e mësimave dhe rekomandimeve që do të udhëzojnë ciklin e ardhshëm të planifikimit strategjik.

Strategjia e komunikimit

Një strategji efektive komunikimi dhe ndërgjegjësimi përbën një komponent kyç për zbatimin me sukses të planit. Ajo siguron që qytetarët të jenë të informuar, të angazhuar dhe të fuqizuar për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të përfituar nga shërbimet që u ofrohen. Komunikimi shërben njëkohësisht si instrument transparence dhe si urë lidhëse ndërmjet institucioneve dhe komunitetit, duke nxitur besimin dhe përfshirjen.

Qëllimet kryesore të strategjisë së komunikimit janë:

- Informimi i qytetarëve mbi shërbimet sociale të disponueshme dhe kriteret e përfitimit;
- Inkurajimi i raportimit të rasteve të diskriminimit, dhunës dhe shkeljeve të të drejtave;
- Promovimi i pjesëmarrjes qytetare në hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave sociale;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi sfidat sociale dhe situatën e grupeve vulnerabël.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, Bashkia Shkodër do të përdorë një kombinim mjetesh komunikimi digjitale, në format të shkruar dhe në nivel komunitar. Platformat e rrjeteve sociale dhe faqja zyrtare e bashkisë do të shfrytëzohen për shpërndarjen e informacionit në kohë reale, përditësimeve dhe historive të suksesit. Materialet e shtypura dhe fletëpalosjet informuese do të shpërndahen përmes njësive administrative, qendrave komunitare, shkollave dhe institucioneve shëndetësore, për të siguruar që informacioni të arrijë te të gjithë qytetarët, përfshirë edhe ata me akses të kufizuar në mjetet digjitale.

Fushatat ndërgjegjëse dhe aktivitetet komunitare do të organizohen në mënyrë të rregullt, duke nxitur pjesëmarrjen dhe dialogun, veçanërisht te të rinjtë dhe grupet e marginalizuara. Partneritetet me shkollat, organizatat, aktorët e shoqërisë civile dhe mediat lokale (radio, televizion dhe shtyp) do të garantojnë një shtrirje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse të komunikimit.

Përmes këtyre përpjekjeve të kombinuara, Bashkia Shkodër synon të forcojë ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre sociale, të promovojë angazhimin aktiv dhe të ndërtojë besim të qëndrueshëm ndërmjet komunitetit dhe institucioneve vendore.

SHTOJCAT

Shtojca A	Monitorimi dhe treguesit
	Dokumente teknike
Shtojca B1	Korniza strategjike dhe ligjore
Shtojca B2	Struktura institucionale
Shtojca B3	Programi i ndërtimit të kapaciteteve për

	stafin
Shtojca B4	Lista e konsultimeve të mbajtura
Shtojca B5	Plani i mundshëm i prokurimit
	Planet fillestare sektoriale
Shtojca C1	Plani Social Vendor
Shtojca C2	Plani Lokal i Rinisë
Shtojca C3	Plani i Strehimit Social
Shtojca C4	Plani Lokal për Barazinë Gjinore

SHTOJCA A1: MONITORIMI DHE TREGUESIT

SHIKO EXCEL PËR T'U INTEGRUAR PAS PËRFUNDIMIT

